



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 258, Datë 17.12.2018

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË
“RTS” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, NË ZONËN TREN-BILISHT TË
RRETHIT KORÇË, ME FUQI TË INSTALUAR 2MW.**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2 gërma “a” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”; nenit 5, pika 1 gërma “a”; nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimi, Transferimi, Rinovimi ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 109, datë 29.06.2016, si dhe nenit 19, pika 1, gërma “a” të “Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 17.12.2018 mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “RTS“ sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, në zonën Tren-Bilisht të rrethit Korçë, me fuqi të instaluar 2MW,

Konstatoi se:

Shoqëria “RTS” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 747 Prot., datë 22.11.2018, ka paraqitur aplikimin, për tu pajisur me liçencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik në zonën Tren-Bilisht të rrethit Korçë me fuqi të instaluar 2 MW.

Aplikimi i shoqërisë “RTS” sh.p.k, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “e” dhe “f”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërmat “b” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.4.1; pika 4.4.2; pika 4.4.3; pika 4.4.4; pika 4.4.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me :

- Nenin 9, pika 2, gërma “d”, - (vërtetimi nga Prokuroria, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Shkallës së Parë Tiranë). **Plotësuar pjesërisht.** Subjekti ka përcjellë në ERE vërtetimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Tiranë, dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Shkallës së Parë Tiranë, të datës 02.11.2018, për administratorin z. Edmond Zalla Mungojnë vërtetimi i Prokurorisë dhe Gjykatës për vetë subjektin “RTS” sh.p.k.
- Nenin 9, pika 2, gërma “g”, dokumenta që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (kontrata shit-blerje, kontrata qiraje, akte dhurimi, kontrata premtim shitblerje, marrëveshje me subjektet që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti për ato veprimtari që përdorin asete për kryerjen e veprimtarisë së licencuar). Aplikuesi ka paraqitur Kontratën e Qirasë Nr. 1890 Rep dhe Nr. 1077/3 Kol, datë 11.09.2018, të lidhur me qiradhënësin Bashkia Devoll, për një afat 20 vjeçar, por në të cilën nuk parashikohet e drejta e përsëritjes, e cila nuk mbulon periudhën e jetëgjatësisë së paneleve e cila është parashikuar të jetë 25 vjet.
- Nenin 9, pika 3, gërma “a”, vërtetimi për shlyerjen e tatim – taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore (për shoqëritë e sapokrijuara vërtetim që nuk ka detyrime): **Plotësuar pjesërisht.** Subjekti ka paraqitur vërtetimin nga Drejtoria Rajonale e Tatim –Taksave Korçë. Nuk ka paraqitur vërtetimin për sigurimet shoqërore.
- Nenin 9, pika 3, gërma “c”, (dokumenta që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit). **Plotësuar pjesërisht.** Për financimin e projektit që do të realizohet në masën 30% nga ortakët, subjekti nuk ka depozituar në ERE dokumenta mbështetës.
Do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike*”,
- Subjekti “RTS” sh.p.k ka lidhur Kontratën me Nr. 2156 Rep dhe Nr.115/6 Kol, datë 08.10.2018, me MIE për një afat 49 (dyzetëntë) vjeçar, por nga ana tjetër ERE në zbatim të nenit 38 të Ligjit “*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*”, i ndryshuar dhe nenit 5 të “*Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licensave në Sektorin e Energjisë Elektrike*”, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të gjatë se 30 vjet. Por duke qënë se nga të dhënat për projektin e centralit rezulton se jetëgjatësia e pritshme e një paneli është 25 – vjet, atëherë ERE kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në dhënien e afatit maksimal për një licencë fotovoltaike, deri në 25 vjet.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë e procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “RTS” sh.p.k, për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik në zonën Tren-Bilisht të Rrethit Korçë, me fuqi të instaluar 2MW, për një afat 25 vjeçar
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI